




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, pika c të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale nenit 17, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit Nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe në zbatim të nenit 36, paragrafi 3, të Rregullës Financiare Nr.01/2013-MF – Shpenzimi i parave publike dhe Neni 20 par. 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15nr.011-23133 të datës 06.05.2015, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 27. 06. 2019, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

RREGULLORE PËR NDARJEN E SUBVENCIONEVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i miratimit të kësaj Rregulloreje është që t'u ndihmohet me mjete financiare pa kthim, personave juridik dhe fizik të cilët jetojnë dhe zhvillojnë aktivitete në territorin e Komunës së Lipjanit, për arritjen e qëllimeve në avancimin dhe zhvillimin e aktiviteteve ekonomike, edukativo arsimore, të mbrojtjes shëndetësore dhe sociale, të përkrahjes dhe integritit të komuniteteve, të përparimit të bujqësisë si dhe të zhvillimit të kulturës dhe sportit .

Neni 2

Objekti i Rregullimit

1. Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, kriteret dhe procedurat të cilat i mundësojnë Komunës të ndajë mjete financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve për fushat e cekura në këtë rregullore për personat fizik juridik.
2. Dispozitat e kësaj Rregulloreje nuk zbatohen për rastet e mbështetjes financiare për OJQ-të e cila mbështetje financiare, tejkalon shumë prej pesëqind (500 €) euro për një OJQ, përveç në raste të gjendjes së jashtëzakonshme të përcaktuar me legjislacionin në fuqi kur është e pamundur të pritët për të zhvilluar një thirrje publike.
3. Për çdo ndarje buxhetore për OJQ-të që tejkalon shumë mbi pesëqind 500 €, përveç në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme siq përcaktohet në paragrafin 2 të këtij neni do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

4. Për çdo ndarje të subvencioneve konform dispozitave të kësaj Rregulloreje që tejkalon shumën mbi 2000 €, nevojitet marja e pëlqimit nga ana e Kuvendi Komunal.
5. Për çdo ndarje buxhetore duhet të nxirret Vendim mbi ndarjen e mjeteve financiare i cili duhet të nënshkruhet nga Kryetari i Komunës.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

1.1 **Subvencionet** - në kuptim të kësaj rregulloreje përfshijnë transferet e njëanshme, të pakthyeshme të mjeteve buxhetore të institucionit, në llogarinë rrjedhëse të përfituesve, të ardhurat e të cilëve nuk mbulojnë shpenzimet e caktuara përkatëse për arritjen e një qëllimi të ligjshëm për interes publik.

1.2 **Pagesa e pakthyeshme** - është e njëanshme atëherë kur nuk ka mallra dhe shërbime që rrjedhin si kompensim ose kundërvlerë për pagesën.

1.3 **Përfituesi** - nënkupton personat fizik dhe juridik që përfitojnë mjete financiare nga kategoria e subvencioneve të planifikuara në Buxhetin e Komunës dhe në pajtim me Ligjin për ndarjet buxhetore.

1.4 **Banor rezident** - nënkupton personi që jeton dhe vepron në Komunë dhe posedon dokumentacion valid të Republikës së Kosovës.

Neni 4 **Procedurat e përgjithshme për ndarjen e subvencione**

1. Procedura e ndarjes së subvencioneve nga Komuna mund të zhvillohet sipas kërkesave të arsyetuara të palëve dhe në bazë të thirrjes publike.
2. Gjatë ndarjes së subvencioneve, përmes thirrjes publike, përcaktohet qartë fusha e subvencionimit, kriteret, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata tjera me rëndësi.

Neni 5 **Përgjashtimet nga ndarja e subvencioneve**

1. Përfitues të subvencioneve të ndara nga Komuna nuk mund të jenë personat fizik jo rezident të Komunës dhe personat rezident që zhvillojnë aktivitete jashtë komunës.
2. Nëse me fajin e përfituesit nuk përmbushen obligimet e përcaktuara në vendimin, kontratën apo marrëveshjen për ndarjen e subvencioneve, për 3 (tre) vitet e ardhshme përfituesi humb të drejtën në përfitim nga secila kategori e subvencioneve.

Neni 6 **Ndarja e subvencioneve për rastet e fatkeqësive të ndyshme**

1. Kryetari i Komunës në rastet e fatkeqësive të ndryshme apo gjendjes së jashtëzakonshme mund të mbështesë financiarisht individët apo familjet të cilët kanë pësuar humbje të konsiderueshme në njerëz apo të mira materiale të vërtetuar me procesverbal dhe foto nga organet përkatëse komunale apo ndonjë organ tjetër i ngjashëm kompetent për konstatimin, vërtetimin dhe publikimin e gjendjes faktike.

2. Në raste të tilla, Kryetari i Komunës merr Vendim për mbështetje financiare me kërkesën e individit-familjarit e në raste të gjendjes së jashtëzakonshme në mënyrë të drejtëpërdrejtë pa kërkesën e palëve.

3. Në rastet e fatkeqësive dhe gjendjes së jashtëzakonshme për marrjen e Vendimit parashtruesi i kërkesës duhet të bashkëngjies dokumentacionin si vijon:

3.1. Kërkesën të nënshkruar dhe protokoluar (përveq në rastet e jashtëzakonshme kur vendoset drejtëpërdrejtë pa kërkesën e palës)

3.2. Dokument zyrtar mbi gjendjen e vërtetuar faktike

3.3. Fotokopja e letërnjoftimit

3.4. Konfirmimi për xhirollogarinë bankare

Neni 7

Subvencionet për arsim

1. Komuna mund të ndajë subvencione për arsim duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:

1.1. Bursa për studentë

1.2. Mbështetje financiare për student të dalluar apo me gjendje të rëndë ekonomike;

1.3. nxënës me nevoja të veçanta;

1.4. gara apo kuize (aktivitete jashtë mësimore);

1.5. botimin e librave/revistave;

1.6. nxënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;

1.7. mësimdhënësit që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

2. Parshtruesit e kërkesave për subvencionim në fushën e arsimit, duke përjashtuar pikë 1.1 ku ndarja e bursave për student do të realizohet sipas kritereve të përcaktuara me konkurs publik, duhet të bashkëngjiesin dokumentacionin si vijon:

2.1. Dokumenti i identifikimit për të gjitha rastet ndërsa për personat e moshës jo madhore është e nevojshme kopja e letërnjoftimit të prindit,

2.2. Kopja e kartelës së studimeve dhe certifikata e notave - për studentë.

2.3. Dokumentacion mbi gjendjen jo të mirë ekonomike të familjes apo vërtetimin nga enti për punësim për papunësinë e anëtarëve të familjes - për studentë.

2.4. Vërtetimi nga shkolla - për nxënës,

2.5. Vërtetim të lëshuar nga organi kompetent që vërteton invaliditetin apo aftësinë e kufizuar për nxënësin me nevoja të veçanta.

- 2.6. Ekstrakti i lindjes për personat e moshës jomadhore
- 2.7. Profatura për botuesit e librave, revistave.
- 2.8. Ftesa nga institucioni përkatës për gara apo kuize
- 2.9. Rezultatet në gara të dokumentuara me certifikatë apo akt tjetër për nxënës dhe mësime të tjerë që kanë treguar rezultate në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- 2.10 Konfirmimi për xhirollogari bankare në të gjitha rastet ndërsa për fëmijët e moshës jomadhore konfirmimi për xhirollogari bankare i prindit.
- 2.11. Certifikata e vendbanimit për personat e moshës madhore
- 2.12. Varësisht nga arsyetimi i kërkesës mund të kërkojnë edhe dokumente tjera plotësuese të cilat nuk janë përcaktuar në paragrafët tjerë paraprak të këtij neni.

Neni 8

Ndarja e subvencioneve për personat juridik

1. Kryetari i Komunës sipas kërkesave të arsyetuara ndanë ndihmë momentale për kategoritë e personave juridik si në vijim:
 - 1.1 Organizatat joqeveritare aktive
 - 1.2 Institucionet fetare,
2. Komuna ka të drejtë të ndajë subvencione për OJQ-të e ndryshme deri në shumën 500 euro sipas kërkesave – projekteve të tyre (pa shpallje publike) deri në limitin e përcaktuar me dispozita ligjore.
3. Për çdo ndarje buxhetore për OJQ-të që tejkalon shumën mbi pesëqind euro (500 €) përveç në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme siq përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 2 të kësaj Rregulloreje do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
4. Organizatat Joqeveritare dhe Institucionet fetare gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve duhet të bashkëngjisin dokumentacionin si vijon:
 - 4.1 Kërkesa – Projekti
 - 4.2 Certifikatën e regjistrimit për OJQ-të
 - 4.3 Certifikatën e numrit fiskal
 - 4.4 Planin financiar
 - 4.5 Konfirmimi për xhirollogarinë bankare në emër të personit juridik

Neni 9

Subvencionet për bujqësi

1. Komuna ndanë subvencione për bujqësi sipas kërkesave të arsyetuara të palëve ose nëpërmjet shpalljes publike për zhvillimin e aktivitetet në vijim:
 - 1.1 Pemëtarisë,
 - 1.2. Lavërtarisë,
 - 1.3. Blegtorisë,
 - 1.4. Shpeztarisë,

1.5. Perimtarisë,

2. Parashtruesit e kërkesës gjatë aplikimit për ndarjen e subvencioneve në bujqësi duhet të plotësojnë dokumentacionin si vijon:

2.1 Fotokopjen e Letërnjoftimit

2.2 Konfirmimi për xhirollogari bankare (rastet kur fermerët mbështeten me mjete financiare)

2.3 Fletëposedim për patundshmëri

2.4 Vërtetim mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë .

3. Në qoftë se ndarja e subvencioneve në bujqësi realizohet nëpërmjet thirrjes publike, Komuna ka të drejtë të përcaktojë në konkurs publik edhe kritere tjera shtesë .

4. Thirrja publike për ndarjen e subvencioneve në bujqësi duhet të publikohet në faqen zyrtare të Komunës dhe të jetë e hapur së paku 15 ditë kalendarike. Pas mbylljes së shpalljes publike, Kryetari i Komunës formon Komisionin për shqyrtimin e kërkesave si dhe Komisionin për shqyrtimin e ankesave pas publikimit të listës së përfituesve. Komisionet duhet të kenë përbërje gjinore ndërsa detyrat, përgjegjësitë dhe mandati i këtyre do të rregullohet më detajisht në Vendimet për themelimin e tyre. Pas përfundimit të procedurave të ankesave Kryetari i Komunës lidh Kontratë – Marrëveshje me shkrim me secilin përfitues.

5. Në rastet e fatkeqësive të ndryshme natyrore kur fermerët kanë pësuar dëme të konsiderueshme në bujqësi ose blegtori, Komuna nëse e lejon mundësitë buxhetore mund të mbështesë financiarisht këto raste sipas kërkesave të arsyetuara të palëve të cilët duhet të bashkëngjeshin edhe dokumentacionin si vijon:

5.1 Procesverbal apo dokument tjetër me foto të lëshuar nga organi kompetent i cili ka vërtetuar gjendjen faktike pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme,

5.2 Fotokopjen e Letërnjoftimit

5.3 Konfirmimin për xhirollogarinë bankare.

Neni 10

Subvencionet për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

1. Komuna ndanë subvencione për banorët rezident për çështje shëndetësore dhe mirëqenie sociale

Ndihmë financiare i ndahet individit apo familjes për rastet si në vijim:

1.1 Individit apo familjes me gjendje të vështirë ekonomike, pa kurrfarë burimi të të ardhurave personale që nuk janë në asistencë sociale,

1.2 Individit apo familjes që janë në asistencë sociale,

1.3 Individëve të cilët vuajnë nga sëmundjet e ndryshme (me gjendje jo të mirë ekonomike),

1.4 Personave me aftësi të kufizuara dhe të meta mentale.

2. Gjatë ndarjes së subvencioneve në shëndetësi, në kushte të barabarta komuna u jep përparësi rasteve specifike në vijim:

- 2.1. Numri i anëtarëve të familjes;
- 2.2. Kostoja e trajtimit;
- 2.3. Gjendja ekonomike familjare;
3. Komuna brenda mundësive buxhetore, mund të ndihmojë-subvencionojë familjet me gjendje të rëndë ekonomike për renovimin apo ndërtimin e shtëpive të banimit sipas kërkesave të arsyetuara të palëve dhe verifikimit të gjendjes së vërtetë faktike në teren nga organi përkatës - DSHPS.
4. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për shëndetësi dhe mirëqenie sociale nga personat fizik përfshijnë, duke mos u kufizuar:
 - 4.1 Dokumentacioni mjekësor i mjekut specialist te rastet e sëmundjeve,
 - 4.2 Kartela e asistencës sociale (rastet me gjendje të rëndë ekonomike që janë në asistencë sociale),
 - 4.3 Fotokopja e letërnjoftimit (në të gjitha rastet),
 - 4.4 Konfirmimi për xhirollogarinë bankare (në të gjitha rastet),
 - 4.5 Fotokopja e certifikates së lindjes (për fëmijun),
 - 4.6 Kopjen e Aktit – dokumentit zyrtar që vërteton se personi është me aftësi të kufizuara apo të meta mentale (te rastet e personave me aftësi të kufizuara),
 - 4.7 Raporti përkatësisht Rekomandimi i organit përkatës - DSHP për vërtetimin e gjendjes së vërtetë faktike (te rastet e kërkesave për mbështetje financiare për renovim apo ndërtim të shtëpive të banimit).

Neni 11

Subvencionet për kulturë, rini, sport

1. Komuna mund të ndajë subvencione për kulturë, rini dhe sport duke përfshirë, por duke mos u kufizuar, për:
 - 1.1. Klubet sportive
 - 1.2. OJQ-të
 - 1.3. Sportistët e dalluar
 - 1.4. Garat sportive
 - 1.5. Shoqëritë amatore (ansamblet)
 - 1.6. Botimi i librave
 - 1.7. Ekspozitat me fotografi
 - 1.8. Teatrot amatore
 - 1.9. Festivalet
 - 1.10. Aktivitete me karaktere garuese
 - 1.11. Pjesëmarrje në festivale jashtë komune dhe jashtë vendit
 - 1.12. Promovim i librave
 - 1.13. Promovim i talentëve të rinjë
 - 1.14. Aktivitete, kulturore, rinore dhe sportive të organizuara nga DKRS
 - 1.15. KVRL

- 1.16. Klubet letrare
 - 1.17. Aktivitete të ndryshme të organizuara nga Këshillat e fshatrave, lagjeve urbane apo të ngjashme që kanë karakter rinor, kulturor, sportiv dhe human.
2. Gjatë parashtrimit të kërkesës për ndarje të subvencioneve nga fusha e kulturës, rinisë dhe sportit për personat juridik – OJQ-të deri në shumë 500 euro do të zbatohen dispozitat e nenit 8 të kësaj Rregulloreje ndërsa mbi shumën 500 euro do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
 3. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve për personat fizik përfshijnë, por duke mos u kufizuar:
 - 3.1 Kërkesa;
 - 3.2 Dokumenti identifikues;
 - 3.3 Certifikatë e vendbanimit
 - 3.4 Autorizim-Konfirmim i nënshkruar nga Kryesia e Këshillit që sqaron detalisht për numrin e xhirollogarisë bankare ku do të derdhen mjetet financiare për zhvillimin e aktiviteteve të organizuara nga këshillat e fshatrave , lagjeve urbane apo të ngjashme.
 - 3.5 Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit.

Neni 12

Subvencionet për sindikatat e ndryshme

1. Komuna mund të bëjë ndarje të subvencioneve sipas kërkesave të arsyeshme të sindikatave të ndryshme, për realizimin e aktiviteteve dhe projekteve të tyre që konsiderohen të nevojshme për të punësuarit të cilët përfaqësohen nga këto Sindikata.
2. Sindikatat e ndryshme të cilat parashtrojnë kërkesë për mbështetje financiare duhet të prezantojnë dokumentacionin si vijon:
 - 2.1. Aktvendimin e regjistrimit të Sindikatës,
 - 2.2. Certifikatën e numrit fiskal,
 - 2.3. Konfirmimin për xhirollogarinë të Sindikatës,
 - 2.4. Projekti ,
 - 2.5. Planin financiar,
 - 2.6. Varësisht nga lloji i kërkesës mund të kërkohen edhe dëshmi tjera plotësuese.

Neni 13

Subvencionet për mbulimin e shpenzimeve të varrimit

1. Komuna mund të subvencionoj mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e saj.

2. Kjo mbështetje financiare mund të ofrohet nga Komuna varësisht prej vlerësimit të arsyeshmërisë së nevojave apo kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve të ndryshme fetare konform akteve të kuvendit të komunës dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 14

Raportet kthyes nga përfituesit e subvencioneve

Përfituesit e subvencioneve të ndara nga Komuna obligohen që në Komunë të dorëzojnë raport financiar mbi shpenzimin e mjeteve, të cilit duhet t'i bashkëngjeshin edhe faturat, përveç përfituesve në fushën e shëndetësisë, përkujdesjes sociale si dhe familjet që subvencionohen në rastet emergjente nga fatkeqësitë e ndryshme ose gjendjes së jashtëzakonshme.

Neni 15

Monitorimi i përfituesve të subvencioneve

1. Komuna ka të drejtë të iniciojë auditimin e përfituesve për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të ndara nga komuna në formë të subvencioneve.
2. Komuna mund të bëjë monitorimin e përfituesve të subvencioneve, me theks të veçantë të përfituesve në fushën e bujqësisë, kulturë, rini dhe sport, në lidhje me shfrytëzimin e drejtë dhe sipas vendimit apo marrëveshjes, të mjeteve të ndara në formë të subvencioneve.
3. Monitorimi sipas paragrafit 2 mund të bëhet në periudhën kohore deri në 3 vite nga data e përfitimit të subvencionit.

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi 7 ditë pune pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e datës 28.12.2016 si dhe Rregullorja 15Nr.011-6520 e datës 01.02.2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e datës 28.12.2016

15Nr. 011-43473

Lipjan, më 28. 06. 2019

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

